

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 10/12

09 Gusht 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Andrew Hatton, si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarët e EULEX-it Dean Pineles dhe Katja Dominik si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrje të Jana Božovič Këshilltare Ligjore si Oficere Regjistrimi, në çështjen penale kundër:

1. **BQ**, emri i babait SQ, emri i nënës S, i lindur *****, me banim në *****, Sh/K, ka mbaruar shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, me gjendje ekonomike mesatare; i akuzuar me: AKUZA NJË: Pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim i paautorizuar i armëve, sipas nenit 328, par. 1 i KPK-ës (sic –KPPK-ës); AKUZA DY: një akuzë për Detyrimin në Tentativë sipas nenit 267. par. 2 dhe neni 20 i KPK (sic-KPPK-ës).
2. **VQ**, emri i babait F, emri i nënës M, i lindur më *****, me banim në *****, në Mitrovicë, Sh/K, ka mbaruar shkollën fillore, i martuar, baba, me gjendje ekonomike mesatare; i akuzuar me AKUZËN KATËR: Pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim i paautorizuar i armëve, sipas nenit 328, par. 2 i KPPK (sic).

Pas mbajtjes të seancave të shqyrtimit kryesor të hapura për publikun në datat 06, 07, 08 dhe 09 Gusht 2012, të gjitha në prani të të Akuzuarit BQ, Avokatit Mbrojtës të tij Rexhep Kaçaniku, të Akuzuarit VQ, Avokatit Mbrojtës të tij Agim Lushta, Palës së Dëmtuar HA, Përfaqësuesit Ligjor të tij Xhafer Maliqi dhe Prokurores Publike të EULEX-it Elisa Moretti, pas lëshimit të Aktvendimit me datën 07 Gusht për të veçuar akuzën I nga aktakuza, pas diskutimit dhe votimit të trupit gjykues më 09 Gusht 2012, sipas Nenit 392, Paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), shqiptoi në publik dhe në prani të të Akuzuarëve, Avokatëve Mbrojtës të tyre, Palës së Dëmtuar, Përfaqësuesit Ligjor të tij dhe të Prokurores Publike të EULEX-it, lëshon si në vijim:

AKTGJYKIM

AKUZA 2

I Akuzuari BQ, me të dhëna personale si më lartë, është

SHPALLUR FAJTOR

Sepse ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i Akuzuari BQ më 22 Maj 2009 në parkingun e restorantit Va Piano, Mitrovicë, në mënyrë të paligjëshme ka kërkuar 60,000

Euro nga HA duke e kërcënuar atë se nëse të hollat nuk do të paguheshin, diçka serioze do t'i ndodhte familjes apo shtëpisë së tij.

PRANDAJ, i akuzuari BQ është

DËNUAR

për kryerjen e veprës penale të Detyrimit në Tentativë sipas nen. 267 par. (1) dhe nen. 20 i KPK-ës, pasi konsiderohet se elementët e Nen. 267 par. (2) nuk ishin të pranishëm.

Kërkesa për kompensime për palën e dëmtuar HA i është në këtë mënyrë referuar në kontest civil në pajtim me Nenin 112 Paragrafi (1) të KPPK-ës.

PRANDAJ i Akuzuari BQ është

DËNUAR

Me 3 (tre) vjet me burgim për veprën penale të Detyrimit në Tentativë sipas nen. 267 par. (1) dhe nen. 20 të KPK-ës dhe sipas Nen. 65(2) të KPK-ës.

AKUZA 4

I Akuzuari VQ, me të dhëna personale si më sipër, është

SHPALLUR FAJTOR

Sepse ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i Akuzuari VQ, më 24 Maj 2009, në fshatin Kqiq i Vogël, kishte në posedim një Pistoletë TT M57 Cryena Zastava të kalibrit 7.62 mm, me numër serial 21475 së bashku me 3 plumba të të njëjtit kalibër pa leje të vlefshme të autorizimit.

PRANDAJ, i akuzuari VQ është

DËNUAR

për akuzën e kryerjes së veprës penale të Pronësisë, kontrollit, posedimit apo shfrytëzimit të paautorizuar të armëve, sipas nen. 328. par. 2 i KPK-ës.

PRANDAJ i Akuzuari VQ është

DËNUAR

Me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj me burgim për veprën penale të Pronësisë, kontrollit, posedimit apo shfrytëzimit të paautorizuar të armëve, sipas nen. 328. par. 2 i KPK-ës. Ky dënim do të pezullohet për një periudhë dy vjeçare nga data në të cilën ky aktgjykim do të marrë formën e prerë.

Këto artikuj si më poshtë janë konfiskuar në pajtim me Nenin 328 (5) të KPK-ës:

Pistoleta TT M57 Cryena Zastava me kalibër 7.62mm dhe nr. serial 21475 së bashku me karikatorën dhe 3 plumba të të njëjtit kalibër.

I akuzuari BQ dhe VQ duhet që secili të kompensoj gjysmën e shpenzimeve të këtyre procedurave penale në pajtim me Nenin 102 (1) të KPPK-ës me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit me shkrim dhe verbal. Një aktvendim i posaçëm për shumën e shpenzimeve duhet të paraqitet nga gjykata kur të dhënat e tilla janë siguruar në pajtim me Nen 100 (2) të KPPK-ës.

ARSYETIMI

1. Prapavija procedurale

- 1.1 Më 31 Gusht 2011, Zyra e Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë paraqiti më 31 Gusht 2011, Aktakuzën PP 188/09 kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe të pandehurve të tjerë, duke përfshirë HA.
- 1.2 Gjyqtari për Konfirmim i Gjykatës të Qarkut në Mitrovicë, pas shqyrtimit paraprak të Akakuzës, lëshoi më 15 Shtator 2011 një Aktvendim sipas Nen. 306 (2) të KPPK-ës duke i kërkuar Prokurorit të përmisoj Aktakuzën me qëllim që të përmbush kriteret sipas KPPK-ës.
- 1.3 Më 23 Shtator 2011 Prokurori paraqiti Aktakuzën e Përmisuar me datë 21 Shtator 2011. Më 17 Tetor 2011, Prokurori paraqiti Aktakuzën e Përmisuar të re me datë 13 Tetor 2011, e cila përfundimisht u prezantua në Seancën e Konfirmimit.
- 1.4 Seanca e Konfirmimit u mbajt në Gjykatën Komunale të Skenderajt më 26 Janar 2012, në prani të të pandehurve të lartpërmendur, avokatëve të tyre, të lartpërmendurit HA, të të pandehurve të tjerë, avokatëve të tyre dhe Prokurori Publik të EULEX-it.
- 1.5 Gjyqtari i Konfirmimit, në pajtim me Nen. 305 (3) të KPPK-ës, vendosi se nuk duhej të ishte paraqitur një aktakuzë e vetme kundër gjithë të pandehurve. Kështu që, dhe në pajtim me Nen. 34(1) të KPPK-ës, gjyqtari i konfirmimit urdhroi që procedurat të veçohen ndërmjet Akuzave 1, 2 dhe 4, në njërën anë, dhe Akuzat 3, në anën tjetër. I pandehuri BQ u ballafaqua me akuzat 1 dhe 2 dhe VQ u ballafaqua me akuzën 4. I lartpërmenduri HA u ballafaqua me akuzën 3.
- 1.6 Gjyqtari i Konfirmimit lëshoi një Aktvendim mbi papranueshmërinë e disa provave vetëm kundër HA dhe pjesën tjetër të provave i shpalli të pranueshme.
- 1.7 Gjyqtari i Konfirmimit konfirmoi aktakuzën pjesërisht. Akuzat 1 u konfirmua plotësisht, akuzat 2 u konfirmua pjesërisht për të pohuar vetëm detyrimin në tentativë. Akuzat 4 u konfirmua plotësisht. I lartpërmenduri HA ishte për t'u gjykuar veças për

akuzën 3 të konfirmuar pjesërisht. Aktakuza nuk u konfirmua në lidhje me të gjithë të pandehurit e tjerë.

1.8 Aktvendimet e Gjyqtarit të Konfirmimit nuk iu nënshtruan ankesës.

1.9 Shqyrtimi Kryesor u mbajt i hapur për publikun më 6, 7, 8 dhe 9 Gusht 2012 në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës në prani të të dy të pandehurve, avokatëve të tyre, përkatësisht Rexhep Kaçaniku dhe Agim Lushta, Pala e Dëmtuar HA, Xhefer Maliqi, avokat i Palës së Dëmtuar, dhe Elisa Moretti, Prokurorja Publike e EULEX-it.

2. Aktvendimet gjatë shqyrtimit kryesor

2.1 HA, përmes avokatit të tij në fillim të Shqyrtimit Kryesor, kërkoi që të njihet si palë e dëmtuar në procedurat. Ai, nga asnjë pale nuk u kundërshtua që të njihet si palë e dëmtuar, kështu që gjykata vendosi atë si palë e dëmtuar për shkak të përfshirjes së tij në akuzën 2.

2.2 I pandehuri VQ e pranoi fajësinë për akuzën 4 (pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar i armëve, sipas nen. 328(2) të KPK-ës) në Seancën e Konfirmimit. Ai përsëri e pranoi fajësinë, kur aktakuza u lexua në Shqyrtimin Kryesor. Gjykata e shënoi dëshirën paraprake që të pranoj fajësinë, të veçoj VQ nga BQ dhe të vazhdoj gjykimin vetëm kundër BQ. Megjithatë, para se të vazhdohen në këtë mënyrë, kolegji u siguria nga VQ që i ka kuptuar rrethanat e veprës për të cilën ai pranoi fajësinë. Përveç kësaj, ai pranoi se kishte një armë në posedim, ai tha se nuk mund të kujtonte ndonjë gjë tjetër. Në veçanti, ai nuk e pranoi deklaratën e shkruar të LP. Sipas Nen. 359 (2), (3) & (4) të KPPK-ës dhe duke aplikuar Nen. 315 të KPPK-ës, matatis mutandis, në veçanti Nen. 315(3) të KPPK-ës (“e pranuar nga i pandehuri”), Kolegji nuk ishte në gjendje të pranonte deklarinimin e fajësisë në këto rrethana dhe vazhdoi gjykimin për të dy të pandehurit (Nen. 359(4) i KPPK-ës).

2.3 Prova kryesore, nëse pranohej, kundër BQ në akuzën 1 (pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim i paautorizuar i armëve sipas nen. 328 (2) të KPK-ës) erdhi nga FSH. Deklarata e tij nuk u pranua nga BQ. Pjesërisht, besueshmëria e FSH u sfidua mbi baza të ndryshimeve ndërmjet deklaratës që ai kishte dhënë në dëshminë e tij në gjykatë dhe të asaj të dhënë në Polici kur është marrë në pyetje si i dyshuar (Vol 2, f. 181-190). Dëshmitari SH u përpoq që të distancohej nga deklarata e tij e dhënë në Polici në baza se ishte keqtrajtuar nga Policia dhe se ishte nën ndikimin e ilaçeve që kishte marrë. Ai ishte përfaqësuar në atë fazë në rajonin e Policisë nga një avokat. Ishte i njëjti avokat, Rexhep Kaçaniku, i cili ishte duke përfaqësuar BQ në shqyrtimin kryesor. Kjo çështje u diskutua me avokatin. Kolegji konstatoi, pa mosmarrëveshje nga Prokurorja Publike apo mbrojtja, se me qëllim që të shmangeshin vështirësit potenciale për Gjykatën dhe konflikti i interesave për avokatin, akuza 1 duhej të veçohej nga pjesa e tjetër e aktakuzës dhe të shtyhej për t’u gjykuar në një datë të mëvonshme, nëse ishte e përshtatshme. Kolegji u mbështet në Nen. 34 të KPPK-ës.

3. Kompetencat e Gjykatës

3.1 Sipas Nenit 23(1) të KPPK-ës, gjykatat e qarkut kanë juridiksion të gjykojnë në shkallën e parë veprat penale të dënueshme me burgim për së paku pesë vjet apo burgim me afat të gjatë.

3.2 Vepra penale e Detyrimit në Tentativë, nen. 267 par. 2 dhe nen. 20 i KPK-ës (akuza 2) është e dënueshme me burgim nga një deri në dhjetë vjetë dhe vepra penale e pronësisë, kontrollit, posedimit apo shfrytëzimit të paautorizuar të armëve, sipas nen. 328. par. 2 i KPK-ës (akuzat 1 & 4) janë që të dyja të dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet ose me gjobë, kështu që veprat penale bien brenda kompetencës të Gjykatës së Qarkut.

3.3 Sipas aktakuzës, veprat penale ndodhën në Mitrovicë (akuzat 1 & 2) dhe Kqiq të Vogël (akuza 4), ku që të dyja vendet janë nën kompetencën territoriale të Gjykatës Qarkut në Mitrovicë. Kështu që, në pajtim me Nenin 27(1) të KPPK-ës, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës ka kompetenca territoriale të gjykoj për këtë çështje.

3.4 Asnjë nga palët nuk kundërshtoi për përbërjen e kolegjit.

4. Lista e provave të paraqitura

4.1 Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, janë dëgjuar dëshmitarët si në vijim:

- 4.1.1 HA më 06 Gusht 2012
- 4.1.2 FSH më 06 & 07 Gusht 2012
- 4.1.3 BA më 07 Gusht 2012
- 4.1.4 LP më 07 Gusht 2012

4.2 Materialet si në vijim janë pranuar si prova materiale. Disa prova të tjera janë konstatuar si të papranueshme sipas kërkesës së mbrojtjes pas argumenteve ligjore:

Nga Volumi 1:

- Kallëzimi penal më 31 Maj 2009, f. 98-106.
- Lista e provave e dërguar për ekspertizë më 24 Maj 2009, f. 109-110
- Lista e artikujve të konfiskuar të VQ, 24 Maj 2009, f. 117-118.
- Lista e artikujve të konfiskuar të VQ, 24 Maj 2009, f. 124-125
- Raporti i hetimit i Pranvera Delilajt, ID# 7219 e paraqitur më 22 Maj 2009, f. 128-129
- Raporti i Oficer Xhemsit Rushitit, ID# 8468, 23 Maj 2009, f. 130-131 & 132-133.
- Raporti i Oficer Flori Osmanit, ID# 7050, 24 Maj 2009, f. 134-135 & 136-138.
- Raportet e hetimit, Rr. Qazim Ahmetaj, ID# 4916, 2 Qershor 2009, f. 141-146 & 24 Qershor 2009, f. 153-154.
- Kërkesë për ekspertizë të provave, f. 163-164.
- Kontrolli i historisë penale të BQ, f. 296-299.
- Kontrolli i historisë penale të VQ, f. 310-311.

Nga Volumi 2:

- Të tre deklaratat e dhëna nga HA në të cilat ai u sfidua gjatë dëshmisë së tij, e datës 21 Maj 2009 (si dëshmitar), f. 25-30, 22 Maj 2009 (si dëshmitar), f. 31-34, 5 Qershor 2009 (si i dyshuar), f. 35-54.
- Deklaratat e BA më 22 Maj 2009 (si dëshmitar), f. 65-68, 22 Maj 2009 (si dëshmitar), f. 69-77, 29 Maj 2009 (si i dyshuar), f. 78-81, 16 Qershor 2009 (si i dyshuar), f. 82-89.
- Shënimet për VQ në ekzaminimin si i dyshuar, 25 Maj 2009, f. 90-97.

I pandehuri BQ dëshmoi më 08 Gusht 2012.

5. Përmbledhja e provave të paraqitura

5.1 HA. Ai konstatoi se edhe pse nuk mund të kujtonte datën e saktë, atij i kujtohej incidenti që ndodhi në restorantin Va Piano në Mitrovicë. Ai tha se me disa anëtarë të tjerë të familjes së tij, kishin shkuar në restorant për drekë. Para se të arrinte, ai mori një thirrje telefonike në telefonin celular të gruas së tij gjatë së cilës dikush u ankua se një nga djemtë e HA kishte pranuar që të rregullonte një vizë për atë (implikimi ishte se ai pastaj kishte dështuar që të nxirrte vizën sipas asaj që kishte rënë dakord).

Kur djali i tij, B, erdhi në restorantin Va Piano, B tha se ishin tre burra përjashta duke kërkuar HA. Dëshmitari tha se, si pasojë e asaj bisede, ai shkoi jashtë, së bashku me B dhe një të afërm tjetër. Në parkingun e restorantit ndodhej një makinë dhe dikush i kërkoi HA që t'i bashkohej atij në makinë. Dëshmitari tha se ai u ul nga mbrapa në makinë dhe dy burra u ulën përpara; një burrë i tretë qëndroi jashtë makinës.

Dëshmitari tha se ai më vonë mësoi se një nga burrat me të cilin foli brenda në makinë ishte BQ. Ai e identifikoi të pandehurin BQ në sallën e gjyqit.

Dëshmitari tha se ishte në makinë vetëm për një minutë dhe se biseda ishte shumë e shkurtër. Që të dy burrat në makinë i thanë atij: “dikush ka paguar 80,000 Euro për të eliminuar djalin tuaj. Ju na jepni 60,000 Euro dhe ne do ta mbrojmë djalin tuaj”. Ai tha se toni i zërit ishte i qetë. Dëshmitari tha se ai doli jashtë nga makina duke u thënë burrave gjatë kohës që dilte “Unë nuk do t’ju jap as dhe 60 cent”. Ai tha se pastaj iu ribashkua me familjen e tij në restorant ku mbaruan pijet e tyre dhe u larguan; ato nuk qëndruan për drekë, ashtu siç kishin planifikuar, sepse incidenti në parking e kishte “prishur atmosferën”.

Pasi ai dhe familja e tij u larguan nga restoranti, ato vozitën në drejtim të shtëpisë së tyre në Kqiq të Vogël. Në rrugë e sipër atje, gruaja e tij mori një thirrje në telefonin celular. Thirrësi tha “djali i juaj është kidnapuar në Prishtinë”. Dëshmitari e kuptoi atë të nënkuptonte për djalin e tij, E, i cili ishte dërguar në Aeroportin e Prishtinës në atë mëngjes”.

Dëshmitari tha se këto çështje ai i raportoi te policia në të njëjtën ditë dhe se e mori seriozisht incidentin.

Dëshmitari tha se dy herë ishte sulmuar shtëpia e tij në Maj 2009, para incidentit të restorantit Va Piano. (Kolegji ka qenë në dijeni se dëshmitari kishte folur me Policinë më 21 Maj 2009 dhe 18 Maj 2009.).

Dëshmitari tha se më 24 Maj 2009, dy burra erdhën në shtëpinë e tij dhe thanë “pse nuk i përgjigjesh telefonit?” Dëshmitari thirri policinë e cila më vonë erdhën në vend ngjarje. Në sallën e gjyqit, ai tregoi me gisht në drejtim të VQ si njëri nga ato dy burrat që erdhën. Ai tha se VQ kishte një armë në anën e majtë të mesit, arma që policia ia morën kur ato erdhën.

Ai u pyet nga një anëtarë i Kolegjit për deklaratën e tij në Polici më 22 Maj 2009 (vol2, f. 32) dhe ai konfirmoi se biseda në makinë ishte për “mbrojtje”. Ai tha se ai ishte i frikësuar nga njerëzit që ai foli në makinë.

- 5.2 *FSH*. Ishte gjatë dhënies së dëshmisë së tij në gjykatë, kur Aktvendimi i referuar në paragrafin 2.3 u lëshua. Si rezultat, dëshmia e këtij dëshmitari nuk kishte rëndësi në çështjet e ngelura në aktakuzë për këtë gjykim dhe kështu që Kolegji nuk e mori në konsideratë dëshminë e tij, pasi u tregoi palëve qëllimin se do të ndërmernte një gjë të tillë.
- 5.3 *BA*. Atij i kujtohej dita e incidentit në parkingun e restorantit Va Piano. Ai tha se ai më herët kishte dërguar vëllain e tij E tek Aeroporti i Prishtinës pasi kishte për të marrë fluturimin për Slloveni dhe pastaj më vonë kishte marrë një thirrje telefonike nga prindërit e tij që t’u bashkëngjitej atyre në restorantin Va Piano. Ai hyri në restorant por u kthye te makina e tij që të merrte telefonin. Duke bërë një gjë të tillë, dy persona iu afruan atij dhe i kërkuan që të thërras babain e tij të dalë jashtë. Njëri nga këto burra ishte BQ të cilin e kishte njohur atë për disa muaj. Dëshmitari tha se kishte pamje të qartë dhe të papengueshme të BQ gjatë kësaj bisede. Dëshmitari tha se ai thirri babain e tij brenda në restorant dhe pastaj babai i tij iu afrua burrave dhe u fut në makinë. Dëshmitari tha se tre persona ishin të pranishëm në parking, BQ, FU (tani i vdekur) dhe një person e tretë të cilin dëshmitari nuk e njohte. Ishte vetëm BQ dhe babai i dëshmitarit që u ulën së bashku në makinë, dy burrat e tjerë qëndruan përjashta. Dëshmitari tha se ai nuk e dinte se çfarë ndodhi brenda në makinë por babai i tij doli përjashta duke thënë se ai nuk do të jepte as edhe 60 cent. Dëshmitari tha se ai dhe familja e tij mbaruan pijet e tyre në restorant dhe pastaj u larguan pasi nuk ndiheshin të sigurtë që të qëndronin më gjatë për shkak të incidentit në parking. Në rrugë e sipër për në shtëpi, nëna e dëshmitarit mori një thirrje telefonike nga “personat të cilët ishin tek Va Piano” duke thënë se ato kishin marrë (d.m.th. kidnapuar) E (vëllain e dëshmitarit). Dëshmitari konfirmoi se si pasojë, familja ishte e shqetësuar për mirëqenien e E. Dëshmitari i kujtohej incidenti i mbrëmjes në datën 24 Maj 2009. Ai ishte në shtëpinë e tij kur u dëgjua një trokitje në derë. Kur ai doli te dera, ai pa dy persona atje, njëri nga të cilët që njohu ishte VQ. Dëshmitari tha se VQ, që kishte një armë në brezin e tij, tha “pse po i mbani telefonat e fikur?” Dëshmitari tha se VQ donte të merrte armën dhe u përpoq ta nxirrte atë por u çarmatos nga dëshmitari dhe motra e dëshmitarit, të cilët patën ardhur tek dera.
- 5.4 *LP*. Ai tha se në mbrëmjen e datës 24 Maj 2009, ai ishte takuar me VQ i cili po voziste andej me makinën. VQ-i kërkoi dëshmitarit që të shkonte me të në Kqiq “për disa viza”. Ai shkoi me VQ. Ai konfirmoi se VQ kishte një armë në brezin e tij por nuk mund të mbante mend se nga kishte ardhur arma. Ai më herët i kishte thënë policisë se ai kishte parë VQ duke marrë armën nga kroskoti i makinës para se të vendoste në brezin e tij. Ai tha se arma i është marrë VQ kur ato ishin në Kqiq. Dëshmitari tha se nuk mund të kujtohej shumë se çfarë ndodhi kur ato arritën në Kqiq, megjithëse personat që ato takuan atje, ishin të armatosur dhe VQ “nuk kishte mundësi që të nxirrte armën e tij pasi ato tashmë i kishin drejtuar armët tek ne”.
- 5.5 *BQ*. Ai tha se nuk ishte në restorantin Va Piano në kohën kur ishte thënë se ai ishte atje (22 Maj 2009). Kur u pyet se ku ishte, ai fillimisht tha se ai ishte ose në shtëpi, duke

punuar ose duke ushtruar. Më vonë deklarata e tij ishte se në atë kohë ai ishte në Mal të Zi. Kjo akordoi me atë që ai kishte thënë në Polici rreth çështjes në Qershor 2009. (Asnjë tregues formal për mbrojtjen alibi nuk i ishte dhënë Prokurorisë në pajtim me Nen. 308(1) 1)).

Ai tha se nuk e njeh HA dhe se nuk e njeh edhe djalin e tij, EA. Pastaj ai u ballafaqua me disa dokumente financiare të cilat ishin në dosje të gjykatës dhe që ishin shërbyer tek palët (vol 1, f.248). Dokumenti, nga Western Union, tregoi pagesat e bëra për BQ nga EA nga Sllovenia, si në vijim: 1,000 Euro më 21/4/09, 4,300 Euro më 18/3/09 dhe 4,000 Euro më 28/4/09. Ai tha se të hollat i ishin dërguar FU por meqenëse FU nuk kishte letër njoftim, pasi ishte në gjykatën e Vushtrisë: “FU më pyeti mua nëse unë mund t’ia jepja atij letër njoftimin sepse do të merrte disa të holla... çfarë unë bëra, ia dhashë LNJ.-it tim...ai ishte atje, mori LNJ-it tim dhe mori të hollat... me sa di unë, ka qenë veçse një herë që unë bëra këtë.”

U vu në dukje se i njëjti dokument tregonte pagesat të drejtpërdrejta për FU rreth të njëjtës kohë (implikimi ishte se FU kishte LNJ.-it të tijën ose ndryshe si mund ti kishte marrë ato të holla), por i pandehuri tha se ishte e pamundur dhe nuk mund të vërtetohej.

Kur u vu në dukje se karta e identifikimit të tij ishte një LNJ. me fotografi (kopja e të cilës gjendet në dosjen e gjykatës) dhe ai u pyet se si FU ka përdorur atë në këto rrethana. Ai pastaj e ndryshoi deklaratën e tij dhe tha se ai shkoi tek Western Union me FU, dhe se ai, BQ, mori të hollat dhe pastaj ia dorëzoi FU tek dera e ndërtesës. Ai tha se mund të kujtonte duke bërë një gjë të tillë vetëm një herë por se ai nuk thoshte se dokumentet e Western Union janë të gabueshme.

5.6 VQ. Ai zgjodhi që të mos dëshmoj apo të deklarohej por tha se i qëndron asaj se çfarë ka thënë në Polici. Në atë deklaratë (të datës 25.5.09, vol 2, f. 90-93) ai tha se më 24 Maj 2009, kishte shkuar në shtëpinë e HA në Kqiq të Vogël “të pyeste B që t’i përgjigjej telefonit”. Ai tha se për të bërë këtë gjë, atë e kishte dërguar F (U) dhe se ai kishte shkuar atje me LP, duke arritur rreth orës 20:30. Ai konfirmoi se ai kishte një armë në brezin e tij; ishte arma e tij, ai tha se e ka pasur atë që nga viti 1999 duke e trashëguar atë kur njëri nga vëllezërit e tij kishte vdekur. Ajo ishte një pistoletë TT e zezë i cili thotë se ajo nuk ishte e mbushur. Ai tha se nuk e ka mbajtur pistoletën me vete gjithmonë, por nuk e shpjegoi se pse e kishte me vete në atë rast.

5.7 *Provat Materiale*. Kolegji konsideroi të gjithë provat materiale të cekura më parë.

Ekzistonin dy çështje kryesore të rëndësishme: Ishte e dukshme se ishin dy sulme në shtëpinë e HA në Maj 2009 para incidentit të restorantit Va Piano. Gjithashtu ishte e dukshme se pistoletë që referohet në akuzën 4, i ishte marrë VQ nga anëtarët e familjes A më 24 Maj 2009 dhe u dorëzua tek policia kur ato arritën në vend ngjarje. Arma kishte një karikatorë në të cilën gjendeshin 3 fishekë.

6. Konstatime faktike dhe ligjore

6.1 *Akuza 2:*

(a) Kolegji duhej të konsideronte çështjen nëse BQ ishte, në fakt, i pranishëm tek restoranti Va Piano më 22 Maj 2009 dhe nëse ai ishte përfshirë në bisedën në lidhje me 60,000 Euro. Kolegjit iu kujtua se HA nuk njihej me BQ para asaj dite. Megjithatë, ai e identifikoi BQ në gjykatë si njëri nga ato të pranishmit dhe përfshirjes në bisedë për 60,000 Euro. Më shumë e rëndësishme, megjithatë, dëshmitari BA e kishte njohur BQ para disa muajsh (dëshmi që nuk u sfidua nga mbrojtja). Dëshmitari tha se ai kishte një

pamje drite të qartë dhe të papengueshme të BQ gjatë bisedës së tij me atë në parking dhe ai pa BQ në makinë me HA në kohën kur biseda për 60,000 po bëhej. Ai e konfirmoi identifikimin në gjykatë. Gjykata konsideroi se BA tha se ishte vetëm një person në makinë me HA, ndërsa HA tha se ishin dy persona me të në makinë. Kolegji e pranoi atë si mospërputhje e deklaratave të dy dëshmitarëve por ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se të dy, HA dhe BA ishin të besuar dhe të saktë se BQ ishte prezent dhe ishte (një nga ato) në makinë me HA gjatë bisedës për 60,000 Euro.

- (b) Në marrjen në konsideratë nëse BQ ishte i pranishëm dhe i përfshirë, kolegji konsideroi deklaratën e tij se ai nuk ishte prezent. Edhe pse i pandehuri nuk e ka barrën që të vërtetohet se ishte diku tjetër, kolegji nuk pranoi atë deklaratë as të vërtetohet dhe as të saktë.
- (c) Duke qenë të kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm për prezencën e BQ, kolegji konsideroi nëse po apo jo, vepra e pretenduar e detyrimit në tentativë ishte vërtetuar sipas një standardi të nevojshëm penal, si në vijim:
- (d) Së pari, kolegji konsideroi nëse kjo ishte, nëse vërtetohet, një vepër penale e detyrimit në tentativë sipas Nen. 267 (2) të KPK-ës (më serioze, formë e rëndë e veprës siç pretendohet në padi) apo një vepër e detyrimit në tentativë sipas Nen. 267(1) të KPK-ës (vepra e thjeshtë). Diferenca ndërmjet dy formave të veprës është se për veprat më të rënda nën Nen. 267(2), duhet të vërtetohet me një standard penal të provës se ose (i) autori vepronte si një anëtarë i grupit, (ii) vepra është kryer duke përdorur armë apo instrument të rrezikshëm, apo (iii) kryerja e veprës rezulton në dobi të madhe pasurore [numërimi i paragrafëve është vetëm për lehtësime, nuk është pjesë e Nenit].
- (e) Meqenëse vepra e pretenduar ishte një tentativë (Nen. 20 i KPK-ës) dhe jo një vepër e përfunduar, kolegji ishte në gjendje që të mos konsideroj paragrafin (iii) si më sipër, atë të veprës “që rezulton në dobi të madhe pasurore”, pasi aktualisht, asnjë përfitim nuk u arrit.
- (f) Edhe pse në kohën kur aktakuza u përgatit, u pretendua se BQ kishte një armë me vete në kohën e kryerjes të veprës penale, kolegji konsideron, ashtu si Gjyqtari i Konfirmimit, se nuk kishte prova për këtë. Si rezultat, paragrafi (ii) i mësipërm nuk konsiderohet.
- (g) Kështu që ngelet çështja nëse BQ ishte “duke vepruar si një anëtarë i grupit”, paragrafi (i) i mësipërm. Kolegji pranoi dëshminë e të dyve, të HA dhe BA se ishin *tre* burra të pranishëm që dëshironin të flisnin me HA. Kolegji konsideroi se “një grup” përfshin tre apo më shumë persona (duke u bazuar, mutatis mutandis, në Nen. 274(4) të KPK-ës). Kolegji në këtë pikë duhej të konsideronte nëse ishin dy burra në makinë përveç HA, apo vetëm një. Kolegji preferoi deklaratën e HA, d.m.th. që ishin dy burra përveç atij. Kolegji preferoi deklaratën e tij pasi ai ishte i pranishëm në makinë në atë kohë, ndërsa BA ishte disa metra larg. HA duke i rikujtuar ngjarjet, gjithashtu do të kishte avantazhin e memories së tij për bisedën aktuale në makinë. Kështu që, kolegji besoi që deklarata e tij të jetë e saktë. Pa marrë parasysh, megjithatë, nëse ishin në fakt dy persona në makinë përveç HA apo vetëm një person, kolegji konstatoi se nuk mund të ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se personi apo personat që ishin përjashta makinës e dinin qëllimin apo përmbajtjen e bisedës që do të ndodhte në makinë. Kolegji vetëm mund të jetë i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se ato brenda në makinë kanë qenë me vetëdije të përfshirë në vepër.
- (h) Kështu që, kolegji konstatoi se asnjë nga elementët rëndues që kërkohen nga Nen. 267(2) i KPK-ës nuk ekzistojnë. Prandaj kolegji vazhdoi të diskutojë në baza se vepra ishte, nëse vërtetohet, një vepër e detyrimit në tentativë sipas Nen. 267(1) (forma e thjeshtë e veprës).

- (i) Kolegji konsideroi nëse BQ ka përdorur “forcë apo kërcënim serioz për të detyruar personin tjetër që të veproj apo të mos veproj në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër” siç kërkohet nga Nen. 267(1) të KPK-ës. Kolegji ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se shtëpia e HA ishte sulmuar dy herë para takimit më 22 Maj 2009. Duke e lënë me një anë nëse BQ ishte apo nuk ishte përfshirë në këtë, dhe nuk ekzistonte ndonjë provë se ai ishte përfshirë, këto sulme ishin qartësisht pjesë e prapavijës së përgjithshme të këtij incidenti. Kolegji ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se BQ, në makinë tek parkingu i restorant Va Piano, kërkoi 60,000 Euro nga HA si “të holla për mbrojtje” të mbrojtjes së djalin e HA apo pronën e HA (f. 21, procesverbali i seancës më 6 Gusht 2012). Prandaj, kjo ishte një kërcënim të detyroj HA të jap 60,000 Euro. Veç kësaj, kolegji ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se kjo ishte një kërcënim “serioz”, si nga ana objektive dhe subjektive, për arsyet si në vijim:
- Kishte diskutime për mundësinë e vdekje së djalit të HA,
 - HA besoi se kërcënimi ishte serioz (siç e konfirmoi në dëshminë e tij, të cilën kolegji e pranoi),
 - HA kontaktoi me Policinë në të njëjtën ditë (gjë që tregon se sa seriozisht e ka marrë kërcënimin)
 - Dreka e planifikuar me familjen u prish si rezultat se çfarë ishte thënë (një tregues tjetër që kërcënimi ishte marrë seriozisht –“atmosfera u prish”),
 - Thirrja telefonike e mëpasshme në telefoni celular të gruas të HA – ku ishte thënë se djali i HA ishte kidnapuar – ishte konfirmimi që kërcënimi qëllimisht të merrej seriozisht,
 - Kërcënimi ishte nga ana objektive seriozisht sipas mendimit të kolegjit
- (j) Kështu që, kolegji konsideroi nëse BQ ishte duke vepruar “me qëllim të përfitoj një dobi të paligjshme për vet-veten.....apo për person tjetër” siç kërkohet nga Nen. 267(1) i KPK-ës. Duke kërkuar 60,000 Euro në mënyrën e përshkruar, kolegji ishte kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se BQ ishte duke vepruar me qëllim të nevojshëm.

6.2 Akuza 4:

- (a) Kolegji ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm për provat materiale dhe në dëshmitë e drejtpërdrejta të HA, BA dhe LP se VQ ishte i pranishëm në shtëpinë e HA në mbrëmjen e 24 Majit 2009. Ai ishte i armatosur me pistoletë të cilën e kishte futur në brezin e pantallonave. Kolegji ishte i kënaqur, kështu që ishte i sigurtë se arma kishte 3 fishekë në karikatorë e cila ishte në armë. Kolegji nuk ishte i sigurtë se kur arma ishte futur në brezin e tij por ishte i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se prezenca e saj atje nuk ishte aksidentale; ajo ishte atje me synim të imponoj çështjen për të cilën kishte shkuar te shtëpia për ta bërë dhe të përdorej nëse do të ishte e nevojshme. Ai kishte shkuar atje në mënyrë të qartë për të vazhduar një grindje të çdo lloji, qoftë për vizat (ashtu siç LP tha në dëshminë e tij) apo për ndonjë çështje tjetër.
- (b) Kolegji gjithashtu konsideroi se VQ nuk e sfidoi provën në lidhje me posedimin e armës dhe dëshiroi të deklarohet fajtorë edhe pse deklarimi u refuzua (siç u tregua më sipër në këtë dokument) për shkak të paaftësisë për të kujtuar ndonjë rrethanë. Ai pranoi veprën në deklaratën përmbyllëse të tij kundrejt kolegjit.

7. Dënimi

7.1 Çështjet e përgjithshme:

Me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, Gjykata duhet të ketë ndër mend që të dy qëllimet e ndëshkimit, atë të *përgjithshmin, d.m.th* nevoja të zvogëlojë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke parandaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme, dhe qëllimi *specifik, d.m.th.* të parandalojë kundërvajtësin nga ri-përsëritja.

Kolegji erdhi në përfundim që vetëm me shqiptimin e dënimit që u caktua në këtë çështje do të arriheshin ato qëllime. Kolegji vlerësoi të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas nenit 64(1) të KPK duke mbetur brenda kufijve të ofruara në ligj.

7.2 Akuza 2

I pandehuri BQ u dënua për veprën penale të Detyrimit në Tentativë sipas nen. 267 par. (1) dhe nen. 20 KPK-ës, siç tregohet më lart. Dënimi për veprën penale të detyrimit sipas Nen. 267(1) është burgimi nga tre muaj deri në pesë vjet. Sipas meritës nga neni 65(2) KPK, për shkak se kundërvajtja ishte në tentativë, dënimi maksimal duhet të jetë jo më shumë se tre të katërtat e atij maksimumi prej 5 vitesh, pra, 45 muaj burgim.

Kolegji konstatoi këto *veçori rënduese*:

- BQ ka një dënim për vjedhje të rëndë, d.m.th. kundërvajtje e pa-ndershmërisë dhe kundër pronës;
- Ka qenë qëllimi i BQ të përfitojë dobi pasurore të **konsiderueshme**;

Kolegji konstatoi këto *veçori lehtësuese*:

- Kundërvajtja ishte kryer tre vjet më parë

Kolegji nuk u informua nga asnjë avokat për kohën që ka kaluar BQ në paraburgim dhe vetëm tregoi për periudhën (të paspecifikuar) të arrestit shtëpiak atëherë kur dispozitivi u lexua. Në bazë të nenit 73(1) KPK çfarëdo kohë e kaluar në paraburgim si dhe ndonjë periudhë e heqjes të lirisë lidhur me veprën penale duhet të përfshihet në dënimin e burgimit të dhënë nga kolegji. Ndaj vijon, në ligj, që nëse ka pasur ndonjë periudhë kohore të paraburgimit apo heqjes së lirisë lidhur me këtë çështje në mënyrë automatike do të hiqet nga dënimi i shqiptuar.

7.3 Akuza 4:

I pandehuri VQ është dënuar për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 (2) KPK. Kundërvajtja dënohet me gjobë prej 7,500 eurove ose me burgim nga një deri në tetë vjet.

Kolegji konstatoi këto *veçori rënduese*:

- arma ishte në brezin e pantallonave , që shikohej qartësisht, në rrugë dhe ishte në posedimin e tij që së paku të frikësojë;
- arma kishte karikatoren që përmbante tre fishekë dhe kështu që ishte gati që të shkreh brenda një kohe shumë të shkurtë po të ishte e nevojshme;
- incidenti i 24 Majit 2009 ishte pjesë e fushatës të frikësimit kundrejt familjes A;
- parandalimi është posaçërisht i nevojshëm pasi që krimet me armë janë përhapur dhe është me rëndësi që publiku të kuptojë që gjykatat e marrin këtë kundërvajtje seriozisht.

Kolegji konstatoi këto *veçori lehtësuese*:

- Kundërvajtja është kryer tre vjet më parë;
- I pandehuri dëshiroi të pranojë fajësinë;
- I pandehuri i shprehu keqardhje gjykatës;
- I pandehuri nuk ka dënime;
- I pandehuri tani është i martuar me fëmijë.

Në pezullimin e dënimit me burgim që ishte përcaktuar, kolegji kishte ndërmend nenin 44 KPK-ës dhe urdhëroi pezullimin në bazë të sjelljes në të kaluarën të të pandehurit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Kolegji konsideron se qëllimet e dënimit me kusht janë përmbushur.

8. Artikujt e konfiskuar

Në pajtim me Nenin 328(5) të KPK-ës, kolegji urdhëroi që artikujt e mëposhtëm të konfiskohen për sa i përket akuzës 4:

Pistoleta TT M57 Crvena Zastava e kalibrit 7.62mm me nr. serial 21475 së bashku me karikatorin dhe 3 plumbat të të njëjtit kalibër.

9. Shpenzimet

Ato janë dënuar për çështjet për të cilat kolegji ka diskutuar, i akuzuari BQ dhe VQ duhet që secili prej tyre të kompensoj gjysmën e shpenzimeve të këtyre procedurave penale në pajtim me Nenin 102(1) të KPPK-ës me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit me shkrim dhe verbal. Një aktvendim i posaçëm mbi shumën e shpenzimeve duhet të lëshohet nga gjykata kur këto të dhëna të sigurohen në pajtim me Nen. 100(2) të KPPK-ës.

I përgatitur në gjuhën Angleze, gjuha e autorizuar.

Andrew J. Hatton

Dean Pineles

Katja Dominik

Kryetari i Trupit Gjykses

Anëtar i Kolegjit

Anëtar i Kolegjit

Jana Bozovic

Zyrtarja e Regjistrimit

Mjetet Ligjore:

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër këtij dënimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes të këtij aktgjykimi në pajtim me Nen. 398(1) të KPPK-ës te Gjykata Supreme përmes Gjykatës Qarkut në Mitrovicë.

Ankesa duhet të prezantohet brenda tetë (8) ditësh nga data e dënimit.

